



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 shkurt 2022
Nr.ref.:RK 1943/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI62/21

Parashtrues

Dragana Isailović

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I.-18-0413-A0001 të 29 tetorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Dragana Isailović me vendbanim në komunën e Krlevës, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-I-18-0413-A0001] të 29 tetorit 2020 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [SCL-11-0041] e 6 qershorit 2018 të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar).
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 1 dhjetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe nenin 1 (E drejta për punë) dhe nenin 4 (E drejta për pagë të drejtë) të pjesës II të Kartës Sociale Evropiane (në tekstin e mëtejme: KSE).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 30 mars 2021, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 7 prill 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).
8. Më 8 prill 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë

Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS) për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të paragrafit 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr. KK-SP 71-2/21, u konfirmua që Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani do të merrte pozitën e Kryetares së Gjykatës pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
10. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullin 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.
11. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin KSH 62/21, caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
12. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohej kryesuese e Kolegjeve shqyrtuese në rastet ku ajo ishte caktuar anëtare e Kolegjit, përfshirë edhe rastin aktual.
13. Më 25 qershor 2021, në bazë të paragrafit 4, të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës Nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori funksionin e Kryetares së Gjykatës, ndërsa në bazë të pikës 1.1, paragrafi 1, i nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi e përfundoi mandatin e Kryetares dhe Gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 8 nëntor 2021, Gjykata i kërkoi DHPGJS-së që të dorëzojë një kopje të vërtetimit se kur i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës aktgjykimi i Kolegjit të Apelit [AC-I.-18-0413-A0001] të 29 tetorit 2020.
15. Më 9 nëntor 2021, DHPGJS-ja dorëzoi në Gjykatë vërtetimin për dorëzimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit [AC-I.-18-0413-A0001], të 29 tetorit 2020, parashtrueses së kërkesës, me datën e dorëzimit 1 dhjetor 2020.
16. Më 29 janar 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 23 korrik 2010, në bazë të shkresave të lëndës, filloi procesi i privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore Auto Moto Mustafa Bakia nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: NSH "Auto Moto") dhe e cila u vendos nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP). Bazuar në të njëjtat

shkresa të lëndës, parashtruesja e kërkesës më 23 tetor 1995 kishte themeluar marrëdhënie pune me NSH "Auto Moto", në të cilën, sipas pretendimeve të saj, ajo punoi deri në qershor 1999.

18. Më 31 dhjetor 2010, AKP-ja filloi procedurën e likuidimit të NSH "Auto Moto".
19. Më 2 mars 2011, parashtruesja e kërkesës parashtrroi në Komisionin për likuidimin e ndërmarrjes shoqërore të lartpërmendur (në tekstin e mëtejme: Komisioni për likuidim), kërkesë për (i) kompensim të 20% (njëzet për qind) të të ardhurave të privatizimit; (ii) pagesën e aksioneve të NSH-së dhe (iii) pagesën e pagave të papaguara për periudhën nga fillimi deri në fund të procesit të likuidimit të ndërmarrjes shoqërore.
20. Më 19 maj 2011, Komisioni për likuidim me Vendimin [Pej183-0015, 0016, 0023, 0024], (i) shpalli veten jokompetent lidhur me kompensimin prej 20% (njëzet për qind) të privatizimit të ndërmarrjes shoqërore me arsyetimin që, *"nuk është organ kompetent që të merret me 20%, me kërkesa të tilla merret Departamenti për 20% në Prishtinë"*, (ii) refuzoi kërkesën për *"pagesën e aksioneve"* të NSH-së me arsyetimin që *"NSH Auto Moto Start, nuk është Shoqëri aksionare por ndërmarrje shoqërore"* dhe (iii) refuzoi kërkesën e parashtrueses për pagesën e të ardhurave personale të papaguara duke u thirrur në nenin 608 të Ligjit të punës së bashkuar të vitit 1976 (në tekstin e mëtejme: Ligji vjetër i Punës), sipas të cilit *"e drejta për të kërkuar pagesën e të ardhurave personale dhe të drejtave tjera të punësimit skadon pas 3 viteve, në përputhje me parimet e parashkrimit"*.

Procedura përkitazi me të drejtën në 20% (njëzet për qind) të privatizimit të NSH Auto Moto Start

21. Më 30 qershor 2012, AKP-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë kompensimi prej 20% (njëzet për qind) nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së "Auto Moto", në të cilin nuk ishte përfshirë parashtruesja e kërkesës.
22. Më 16 korrik 2012, parashtruesja e kërkesës kontestoi listën përfundimtare, duke parashtruar padi në DHPGJS, duke pretenduar të drejtën e kompensimit prej 20% (njëzet për qind) të të ardhurave nga privatizimi i NSH Auto Moto Start, me kërkesë që emri i saj të përfshihet në listën përfundimtare.
23. Më 31 mars 2014, Kolegji i Specializuar me Aktgjykimin [C-11-12-0029-C-0001], aprovoi padinë e parashtrueses së kërkesës për sa i përket të drejtës për 20% të privatizimit të NSH-së, si të bazuar, dhe urdhëroi përfshirjen e emrit të parashtrueses së kërkesës në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë kompensimi prej 20% nga privatizimi i NSH-së "Auto Moto".
24. Më 16 maj 2014, kundër aktgjykimin të lartpërmendur të Kolegjit të Specializuar, AKP-ja dhe një grup i ish-punonjësve të NSH Auto Moto Start parashtruan padi në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, duke kontestuar të drejtën e një numri të punëtorëve, duke përfshirë vetë parashtruesen e kërkesës, në 20% të privatizimit të NSH-së së përmendur.

25. Më 26 mars 2015, me Aktgjykimin [AC-I-14-0165-A0001-A0003], Kolegji i Apelit refuzoi ankesën e AKP-së dhe të një grupi të ish-punonjësve të NSH Auto Moto Start si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e lartpërmendur të Kolegjit të Specializuar, duke deklaruar, ndër të tjera, se (i) Është e paqëndrueshme gjetja e AKP-së se asnjë prej ankuesve të përfshirë në pikën II të Aktgjykimit të ankimuar nuk paraqiti fakte relevante, në bazë të së cilave do të mund të provohej se nuk janë të barabartë dhe në bazë të cilave do të mund të jepej arsytimi për diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit kundër Diskriminimit, dhe që për këtë arsye ankuesi nuk paraqiti kundër-argumente në lidhje me diskriminimin; dhe (ii) Sa i përket vërejtjeve të bëra nga ky grup i punëtorëve ndaj katër punëtorëve serbë, vërejtjet e tyre nuk u vërtetuan as në këtë rast, përveç spekulimeve, të cilat nuk janë të rëndësishme për Gjykatën, kështu që ky kundërshtim është gjithashtu i pabazuar.

Procedura në lidhje me ushtrimin e së drejtës për të ardhurat personale të papaguara në procesin e privatizimit të NSH Auto Moto Start

26. Më 2 nëntor 2011, kundër vendimit të Komisionit të Likuidimit [Pej 183-0015, 0016, 0023, 0024] të 19 majit 2011, parashtruesja e kërkesës parashtrroi padi në Kolegjin e Specializuar me në kërkesë për (ii) pagesën e aksioneve të NSH Auto Moto Start; dhe (iii) kompensimin për pagat e papaguara për periudhën nga fillimi deri në fund të procesit të likuidimit të kësaj NSH-je.
27. Më 6 qershor 2018, Kolegji i Specializuar me Aktgjykimin [SCL-11-0041], refuzoi padinë e parashtrueses së kërkesës për (ii) pagesën e aksioneve të NSH-së për shkak të mungesës së provave; ndërsa (iii) pagesën e pagave të papaguara për periudhën prej fillimit deri në fund të procesit të likuidimit të NSH-së si të pabazuar dhe vërtetoi vendimin e Komisionit për likuidim, dhe arsyetoi, ndër të tjera që kërkesa për pagesën e pagave të papaguara për periudhën prej 2008 deri në 2010, nuk është parashkruar por e pabazuar, sepse parashtruesja e kërkesës nuk e mbështeti këtë pjesë të pretendimit përmes legjislacionit apo dëshmimeve, ndërsa për periudhën 1999 – 2008, për shkak të parashkrimit.
28. Më 22 qershor 2018, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar së drejtës materiale.
29. Më 29 tetor 2020, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin [AC-I.-18-0413-A0001] refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e lartcekur të Kolegjit të Specializuar, duke pretenduar ndër të tjera, se fakti që parashtruesja e kërkesës ka fituar të drejtën për të marrë 20% nga NSH-ja nuk është bazë ligjore për lidhjen me të ardhurat personale që ajo pretendon se i përkasin asaj, dhe siç ka theksuar Kolegji i Specializuar, kërkesa për të ardhurat personale për periudhën prej 1999 deri më 2006 është parashkruar, ndërsa prej 2006 deri më 2010 nuk është mbështetur me dëshmi.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesja e kërkesës pretendon që me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit [AC-I.-0413-A0001], të 29 tetorit 2020, në lidhje me Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar [SCL-11-0041], të 5 qershorit 2018, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së si dhe nenin 1 (E drejta për punë) dhe nenin 4 (E drejta për pagë të drejtë) të pjesës II të KSE-së.
31. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës thekson: (i) *“Unë, si punëtoreshë e ndërmarrje nuk kam qenë e informuar as drejtpërdrejt as me anë të THIRRJES PUBLIKE, dhe as që kam pranuar ndonjë akt si për angazhim ashtu edhe për ndërprerje të marrëdhënies së punës; i (ii) “VET AKTI I PUNËSIMIT TË DISAVE DHE MOS THIRRJA E AS LAJMËRIMI PËR NE TË CILËT JEMI LARGUAR, MJAFTUESHËM FLET EDHE PËR NJË MËNYRË TË DISKRIMINIMIT”.*
32. Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës thekson, ndër të tjera, se (i) marrëdhënia e saj e punës me ndërmarrjen përkatëse nuk ishte ndërprerë asnjëherë; (ii) procedura e paraparë në nenet 71 (Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës) dhe 72 (Procedura para ndërprerjes së Kontratës) të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të 1 nëntorit 2010 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i Punës) si dhe nenin 219 të Ligjit për punën e bashkuar 53/76 të 25 nëntorit 1976 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për punën e bashkuar) nuk ishte respektuar nga ndërmarrja përkatëse, (i) *“gjykata është vënë në rolin e mbrojtësit të palës së paditur”;* (iii) e paditura me asnjë akt të vetin dhe me asnjë veprim nuk ka treguar apo paraqitur qëndrim që ka shqyrtuar dhe ka tentuar të gjejë punë për të paditurën, por e gjithë mbrojtja reduktohet në qëndrimin se e paditura nuk ka të drejtë në të ardhura personale sepse nuk ka punuar dhe që kërkesa është parashkruar; dhe (iii) AKP-ja në mënyrë tendencioze dhe pa shqyrtim adekuat të përgjithshëm të kërkesës, ka injoruar të gjitha provat dhe ka marrë vendim diskriminues.
33. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës thekson që *“në këtë rast ekziston një pritje legjitime për pagesën e pagave të papaguara që nuk janë paguar për shkak të diskriminimit të dukshëm...”.*
34. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) aktgjykimet e kontestuara t'i shpallë *“jo kushtetuese dhe të pavlefshme”;* dhe *“të marrë vendim me të cilin do të krijojë kushte për aprovimin e kërkesës për pagesën e pagave”.*

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

[...]

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet.*

[...]

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose për krahejen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
- 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
- 5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

[...]

Neni 49
[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. *E drejta e punës garantohet.*
2. *Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

[...]

Protokolli i Konventës për mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut

Neni 1
Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Karta Sociale Evropiane

Pjesa II

Neni 1
E drejta për punë

Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen:

1 të pranojnë si një nga synimet dhe përgjegjësitë e tyre parësore arritjen dhe mbajtjen e një niveli sa më të lartë e të qëndrueshëm të mundshëm punësimi, me synim që të arrihet punësim i plotë;

2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht;

3 të krijojnë dhe mbajnë shërbime punësimi falas për të gjithë punëtorët;

4 të japin dhe të nxisin orientim, trajnim dhe rehabilitim profesional të përshtatshëm.

[...]

Neni 4 E drejta për pagë të drejtë

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për një pagë të drejtë, Palët angazhohen:

1 të njohin të drejtën e punëtorëve për një pagë të tillë që do t'u japë atyre dhe familjeve të tyre një standart të përshtatshëm jetese;

2 të njohin të drejtën e punëtorëve për njësi page të shtuar për punën jashtë orarit, me përjashtime në raste të veçanta;

3 të njohin të drejtën e punëtorëve burra e gra për pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë;

4 të njohin të drejtën e të gjithë punëtorëve për një periudhë të arsyeshme njoftimi për përfundimin e punësimit;

5 të lejojnë zbritjet nga rroga vetëm në kushtet dhe në masën e parashikuar nga ligjet ose rregulloret kombëtare ose të fiksuar në marrëveshjet kolektive ose në vendimet e arbitrazhit.

Ushtrimi i këtyre të drejtave do të arrihet me marrëveshje kolektive të përfunduara lirisht, me mekanizma ligjorë të fiksimit të pagave ose me mjete të tjera të përshtatshme me kushtet kombëtare.

[...]

**Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13
MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN
EPRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE**

e 9 majit 2003

Neni 10
Të Drejtat E të punësuarve

[...]

10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6..

[...]

Ligji për punën e bashkuar
GZ RSFJ 53/76
i 25 nëntorit 1976

[...]

Neni 22

[...]

Kushtet për fitimin e të ardhurave në shkëmbimin e lirë të punës përcaktohen me një marrëveshje vetëqeverisëse.

[...]

Neni 219

Punëmarrësit duhet t'i njoftohet me shkrim vendimi se i është ndërprerë marrëdhënia e punës në organizatën bazë dhe arsytet për marrjen e një vendimi të tillë, me udhëzim për mjetin juridik.

[...]

Neni 606

[...]

Nëse përmbushja e detyrimit material të njërit prej pjesëmarrësve në marrëveshjen vetëqeverisëse është bërë i pamundur për shkak të ngjarjeve për të cilat as ai dhe as pjesëmarrësit e tjerë nuk janë përgjegjës, detyrimet e tyre të ndërsjella pushojnë.

[...]

Neni 608

[...]

Me parashkrim përfundon e drejta për të kërkuar përbushjen e detyrimeve materiale që rrjedhin nga marrëveshja vetëqeverisëse, si më poshtë:

1. PAGESA E SHUMËS SË TË ARDHURAVE PERSONALE DHE PRETENDIMEVE TË TJERA TË PUNONJËSVE NGA MARRËDHËNIA E PUNËS.

[...]

Dispozitat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave do të zbatohen në pajtim me rrethanat për parashkrimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, me kusht që këto kërkesa të parashkruhet për tri vjet.

[...]

Ligji nr. 03/L-212

i Punës

i 1 nëntorit 2010

Neni 71

Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;

1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Neni 72

Procedura para ndërprerjes së Kontratës

1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje.

2. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit.

3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

37. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht u referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

38. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I.-18-0413-A0001] e Kolegjit të Apelit të 29 tetorit 2020 dhe se ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
39. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) parasheh në veçanti:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

40. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
41. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 30 prillit 2020; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 275 deri më 304).

42. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtrueses së kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
43. Në këtë drejtim, Gjykata së pari rikujton se rrethanat e rastit në fjalë kanë të bëjnë me të drejtën e pretenduar të parashtrueses së kërkesës të realizoj në procesin e privatizimit të NSH Auto Moto Start të drejtën për (i) kompensim të 20% të të ardhurave të privatizimit; (ii) pagesën e aksioneve të NSH-së dhe kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 1999 - 2010. Parashtruesja e kërkesës së pari paraqiti kërkesën e saj në Komisionin për Likuidimin e NSH-së së përmendur, lidhur me këtë kërkesë në pjesën në lidhje me (i) kompensimin prej 20% të të ardhurave të privatizimit Komisioni për Likuidim u shpall jokompetent dhe pjesën në lidhje me (ii) pagesën e aksioneve të NSH-së, Komisioni për Likuidim e refuzoi si të pabazuar, dhe pjesën në lidhje me (iii) kompensimin e pagave të papaguara për periudhën prej 1999 deri në 2010 e hodhi poshtë për shkak të parashkrimit. Pas kësaj, parashtruesja e kërkesës në lidhje me (i) kompensimin e 20% të të ardhurave të privatizimit të NSH-së realizoi të drejtën e saj në procesin e kryer pranë DHPGJS-së në lidhje me 20% të privatizimit. Përveç kësaj çështjeje, parashtruesja e kërkesës gjithashtu parashtrroi ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Komisionit për Likuidim në lidhje me (ii) pagesën e aksioneve të NSH-së dhe (iii) kompensimin e pagave të papaguara për periudhën prej 1999 deri në 2010, në procedurën e zhvilluar në lidhje me këtë çështje, DHPGJS-ja refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtrueses. Parashtruesja e kërkesës konteston konkluzionet e DHPGJS-së, duke pretenduar (i) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, përkatësisht neneve 71 dhe 72 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, nenit 219 të Ligjit të punës së bashkuar nr. 53/76 si dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe (ii) shkelje të neneve 24, 46, 49 dhe 102 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenit 1 dhe nenit 4 të KSE. Shqyrtimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata do të fillojë me (i) pretendimet e saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe pastaj të vazhdojë me (ii) shqyrtimin e pretendimeve për shkelje të neneve 24, 46, 49 dhe 102 të Kushtetutës si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 dhe nenin 4 të KSE.
44. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës, për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm si dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, të cilat, përbëjnë kategorinë e pretendimeve, të cilat Gjykata, bazuar në praktikën e saj të gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim i konsideron si "*pretendime të shkallës së katërt*".
45. Në kontekst të kësaj kategorie të pretendimeve, Gjykata thekson se, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e

saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesa I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. "Shkalla e katërt", paragrafët 275 dhe 304), si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "kushtetutshmërisë" dhe "ligjshmërisë" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për atë që gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI233/16, parashtrues *Qaush Mulliqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 gushtit 2020, paragrafi 37; KI99/20, parashtrues *Tatjana Stefanović*, Aktvendim i 14 tetorit 2021, paragrafi 42; KI56/17, parashtrues: *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues: *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

46. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe ajo se nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat kanë bërë që një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI99/20, cituar më lart, paragrafi 43; dhe KI233/17, cituar më lart, paragrafi 38).
47. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurojë apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka "aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" për parashtruesin përkatës (për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e "aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar", shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, pjesën IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e Mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës KI99/20, cituar më lart, paragrafët 50 deri në 53 dhe referencat e përdorura aty).

48. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit në fjalë, pretendimet kryesore të parashtrueses së kërkesës në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së kanë të bëjnë me nxjerrjen e aktgjykimit të kontestuar, përkatësisht Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit [AC-I.-18-0413-A0001] të 29 tetorit 2020 në kundërshtim me nenet 71 dhe 72 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe nenit 219 të Ligjit për punën e bashkuar nr. 53/76.
49. Sa i përket këtyre pretendimeve, përkatësisht nxjerrjen e aktgjykimit të kontestuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe dispozitave të Ligjit për punën e bashkuar nr. 53/76, Gjykata së pari thekson se parashtruesja nuk i kishte sqaruar saktësisht dhe nuk i ka paraqitur në mënyrë adekuate faktet për shkelje të të drejtave kushtetuese ose dispozitave. Për më tepër, Gjykata vëren se pretendimet e mësipërme për shkelje të Ligjit të punës nr. 03/L-212 si dhe dispozitat e Ligjit për punën e bashkuar nr. 53/76, janë sqaruar nga gjykatat e rregullta
50. Në këtë drejtim, Gjykata së pari rikujton që Kolegji i Specializuar, me Aktgjykimin [SCL-11-0045] të 6 qershorit 2018, duke shqyrtuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës, theksoi, ndër të tjera:

“Në rastin konkret nuk ekziston njohja e të paditurës, e ankuesja nuk ka deklaruar që ka ndërmarrë çfarëdo veprimi në gjykatë ose organ kompetent, e as nuk ka ofruar shpjegim përse nuk ka qenë në mundësi të iniciojë procedurë në të cilën do të kërkonte përmbushjen e detyrimit. Prandaj, trupi gjykues në përputhje me konstatimin e AKP OL, që të gjitha detyrimet e pa përmbushura para 24 nëntorit 2008, janë parashkruar sipas nenit 608 të LPB-së. Në këtë kuptim, nuk ekziston dallimi në mes të kërkesës së pagave në mes të vitit 1999 dhe 2006 dhe në mes të 2006 dhe 2008. Më tutje, trupi gjykues konstaton që edhe nëse këto detyrime nuk janë parashkruar, kërkesa e ankueses për pagat në periudhën pas 24 nëntorit 2008 është e pabazuar. Pas marrjes në konsideratë të të gjitha informatave në lëndën konkrete, trupi gjykues konstaton që marrëdhënia e punës në mes të palëve, kurrë nuk është ndërprerë, ashtu që e paditura përgjithësisht do të ishte e detyruar të paguajë pagat, megjithatë, kjo është përjashtuar nga ky detyrim sepse ankuesja nuk ka kryer punën e rënë dakord gjatë asaj periudhe”. [...] Vazhdimësia e të drejtave siç janë mbajtja e pronës në parim dërgon tek vazhdimësia e detyrimeve, sikurse të atyre ndaj punonjësve. Kjo do të thotë që e paditura përgjithësisht ka qenë e detyruar të vazhdojë marrëdhënien e punës së ankueses. Ai detyrim ka mundur - përgjithësisht - të përfshijë gjithashtu edhe detyrimin që ajo në mënyrë aktive të kontaktohet dhe që t'i ofrohet që të vazhdojë me punën në momentin kur kjo të jetë e mundur. Në këtë rast, trupi gjykues konstaton që ky detyrim nuk ka ekzistuar më. Në këtë kuptim, merret parasysh që ankuesja ka lëshuar zonën dhe më nuk është kthyer. Prandaj, nuk ka qenë përgjegjësi e të paditurës që ti ofrojë asaj që të vazhdojë punën në vendin e saj paraprak, e ka qenë detyrim i ankueses që të lajmërohet në vendin e punës, po të ishte e interesuar për të. Nuk është e domosdoshme të vërtetohet nga kur kjo do të mund të pritët nga ajo, sepse të paktën në

periudhën kohore e cila është relevante për lëndën konkrete, pas vitit 2008, nuk ka pasur pengesa për ankuesen që të kthehet në Kosovë dhe që lajmërohet në punë. Pasi që ajo ka zgjedhur mos të bëjë këtë, me këtë ka humbur të drejtën në paga për atë periudhë kohore”.

51. Nga ana tjetër, Kolegji i Apelit, me Aktgjykimin [AC-I.-18-0413-A0001] e 29 tetorit 2020, shqyrtoi pretendimet përkatëse të parashtrueses së kërkesës dhe arsyetoi, ndër të tjera, si në vijim:

“Ankuesja për aktgjykimin e kontestuar, konsideron që ky aktgjykim është i padrejtë dhe i pabazuar. Ankuesja thirret në nenin 219 të Ligjit mbi punën e bashkuar, sipas të cilit është sqaruar se si të punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës, respektivisht, të punësuarit i pushon marrëdhënia e punës me vendim me shkrim, me të cilin, po ashtu i mundësohet mjeti juridik të cilin mund të përdorë i punësuarit në kundërshtim të atij vendimi. Ankuesja thekson që interpretimi i nenit 608 të LPB-së ka qenë i pasaktë dhe sipas fjalëve të saj, nuk bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës. Kolegji i apelit, pas shqyrtimit të kërkesave ankimore të ankueses, aktgjykimit të ankimuar dhe provave të administruara dhe argumenteve, ka konstatuar që ankesa është e pabazuar. Në lidhje me kërkesat e apelit për paga të papaguara për afatin 1999-2006, edhe OL-AKP-ja edhe Kolegji i specializuar, me të drejtë kanë refuzuar këtë kërkesë për shkak të parashkrimit. Kolegji i apelit pajtohet me këtë sepse kjo kërkesë është dashur të parashtrohet më së voni gjatë vitit 2009, derisa kërkesa pranë OL-AKP-së është parashtruar më 2 mars 2011, derisa nuk ka ofruar kurrfarë prova për përfundimin e këtij afati të parashkrimit. Lidhur me kërkesën për pronësinë mbi aksionet e NSH-së, nuk janë ofruar kurrfarë prova materiale, që ka ardhur deri tek çfarëdo transformimi ligjor i NSH-së në shoqëri aksionare, kështu që, as ankuesja nuk ka prova të tilla, prandaj me të drejtë është refuzuar kjo kërkesë si e pabazuar.

52. Në fund, Gjykata gjithashtu rikujton që Kolegji i Apelit, me të njëjtin aktgjykim, shqyrtoi pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me faktin se ajo kishte realizuar të drejtën në 20% të privatizimit të NSH-së dhe arsyetoi, ndër të tjera, si në vijim:

“Sa i përket kërkesës për 20 për qind të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, tashmë ekziston një aktgjykim i plotfuqishëm, mbi zgjidhjen e të gjitha kërkesave të cilat i ka marrë Kolegji i apelit të DHPGJS AC-I.-14-00165 të nxjerrë më 26 mars 2015, ku ankuesja (C-0001 – Dragana Isailoviq) është përfshirë në listën e shfrytëzuesve të 20 për qind e të ardhurave nga shitja e NSH-së”.

53. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit, në rrethanat e rastit në fjalë, shqyrtuan dhe arsyetuan pretendimet e parashtrueses së kërkesës, duke përfshirë edhe ato në lidhje me interpretimin e gabuar të dispozitave të ligjit në fuqi. Të njëjtit shqyrtuan pretendimet përkatëse të parashtrueses së kërkesës dhe sqaruan (i) që neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar, i cili përcakton një periudhë parashkrimi tre-vjeçare, është i

zbatueshëm në rastin e parashtrueses së kërkesës, (ii) që parashtruesja e kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e saj në lidhje me të drejtën për aksione në këtë NSH, dhe (iii) që fakti që parashtruesja e kërkesës kishte realizuar të drejtën në 20% të privatizimit të NSH-së nuk është bazë ligjore me të cilën mund të arsyetohen pretendimet e parashtrueses së kërkesës për mospagesë së të ardhurave personale.

54. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, dhe gjithashtu arsyetimet e Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj se gjykatat e rregullta mund të kenë “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesen e kërkesës, dhe rrjedhimisht, pretendimet e saj për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të zbatueshëm, kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “*ligjshmërisë*” dhe nuk janë argumentuar në nivel të “*kushtetutshmërisë*”. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
55. Në këtë drejtim, për t’i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueses së kërkesës, Gjykata thekson se “*drejtësia*” që kërkohet përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet përmes procedurës kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, KI233/19, cituar më lart, paragrafi 57; dhe KI99/20, cituar më lart, paragrafi 51).
56. Kjo më saktësisht nënkupton, se palëve përgjatë një procedure të drejtë dhe të paanshme duhet: (i) tu mundësohet zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; (ii) t’u jepet mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë relevante për rastin përkatës; (iii) t’u garantohet se të gjitha argumentet dhe dëshmitë, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat përkatëse; (iv) t’u garantohet se faktet dhe pretendimet ligjore në vendimet gjyqësore ishin shqyrtuar dhe arsyetuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, (v) t’u garantohet se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe jo arbitrare (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29; dhe rastin e Gjykatës, KI99/20, cituar më lart, paragrafi 56). Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesja e kërkesës nuk ka argumentuar se nuk është kështu.
57. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ndër të tjera, sepse “*gjykata është vënë në rolin e mbrojtësit të palës së paditur, e cila me asnjë akt të vetin dhe me asnjë veprim nuk ka treguar apo paraqitur qëndrim që ka shqyrtuar dhe ka tentuar të zgjidhë çështjen e vazhdimit të ankueses në*

ndërmarrje, por e gjithë mbrojtja e të paditurës shkon në theksimin e qëndrimit që e paditura nuk ka të drejtë në paga sepse nuk ka punuar, kështu që ankesa është parashkruar. Pra, gjykata nuk ka fshehur marrëdhënien e saj mbrojtës ndaj palës së paditur duke mos marrë as edhe për një moment parasysh specifikën faktike të të gjithë situatës (gjendja e pasluftës, pasiguria, kidnapimet, vrasjet, sulmet, gjuajtjet me gurë...), përveç kur është në pyetje mbrojtja e të drejtave të palës së paditur (duke përmendur “forcën madhore” – konfliktet) që është më shumë se e qartë” dhe (ii) shkelje të neneve 24, 46, 49 dhe 102 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së si dhe nenit 1 dhe nenit 4 të KSE, duke bërë pretendime të përgjithshme para Gjykatës pa një shpjegim të saktë dhe adekuat të fakteve dhe pretendimeve për shkelje të këtyre të drejtave kushtetuese.

58. Gjykata rikujton se ajo tanimë ka një praktikë mjaft të konsoliduar gjyqësore, përmes së cilës vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIO2/18, parashtrues: *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafi 36; dhe KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 300 deri më 303).
59. Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesja e kërkesës përtej referimit në nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe përmbajtjes së tyre, dhe përveç formulimit të pretendimeve të përgjithësuara, nuk ka arsyetuar qartë dhe në mënyrë adekuate se si janë shkelur këto nene përmes aktgjykimit të kontestuar. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të neneve të lartcekura të Kushtetutës bien në kategorinë e pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”. Për qëllimet e kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata bazuar në paragrafin (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, vazhdimisht ka theksuar që (i) palët janë të detyruara të sqarojnë faktet dhe pretendimet në mënyrë të saktë dhe adekuate; si dhe (ii) të dëshmojnë dhe mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave ose dispozitave kushtetuese.
60. Prandaj, bazuar në të lartcekurat dhe duke marrë parasysh karakteristikat specifike të rastit, pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, Gjykata, bazuar në standardet e vendosura në praktikën e saj gjyqësore në raste të ngjashme dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të (i) nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit të zbatueshëm në rrethanat e rastit të saj, përbëjnë pretendime të “*shkallës së katërt*”; ndërsa (ii) për shkelje të neneve 24, 46, 49 dhe 102 të Kushtetutës si dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe

të nenit 1 dhe nenit 4 të KSE, përbëjnë pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara” dhe si të tilla, ato janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

61. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës me rezultatin e procedurës nga Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
62. Në pajtim me këtë dhe në fund, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 20 janar 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani